

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL VLORË

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Spitalin Rajonal Vlorë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2012 deri me datë 30.09.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 12, datë 12.02.2016.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 962/12, datë 15.02.2016 i është dërguar Spitalit Rajonal Vlorë, “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Rajonal Vlorë prej datës 03.11.2008 deri në datën 19.12.2008 është kryer auditim nga KLSH dhe rekomandimet e dërguara në raportin përfundimtar të auditimit nr. 631/19 prot., datë 09.03.2009 nuk janë realizuar plotësisht. Konkretisht janë rekomanduar pesë masa për shpërbllim dëmi në vlerën totale 2,403,113 lekë, nga të cilat dy janë zbatuar pjesërisht dhe tre nuk janë zbatuar. Moszbatimi i të gjitha rekomandimeve ka sjellë në total një vlerë dëmi ende të pa arkëtuar prej 2,275,368 lekë, për të cilën detyrohen për arkëtim:

Shuma 55,000 lekë subjekti [REDAKTUAR]; 994,805 lekë ish Drejtori i Spitalit [REDAKTUAR]; 56,614 lekë 4 (katër) ish- punonjës për shpërbllim të padrejtë; 1,168,949 lekë ish- punonjësi [REDAKTUAR] për zhdëmtim makine të humbur dhe shpenzime të pajustificuara karburanti.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Vlorë, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së për shpërbllim dëmi, duke siguruar arkëtimin e vlerës prej 2,275,368 lekë nga personat përgjegjës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit u konstatua se veprimtaria e brendshme e institucionit bazohet në rregulloren e brendshme të hartuar në vitin 1998, në të cilën nuk janë të implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe ndryshime të tjera ligjore. Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe të detyrave të secilit punonjës nuk përputhen plotësisht me ato aktuale. Të gjitha këto kanë penguar kryerjen si duhet të detyrës funksionale nga stafi i institucionit.

Nuk janë kuptuar siç duhet konceptet e MFK-së dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale nga Titullari, të cilat reflektohen nga mosplotësimi i raportit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, mosvlerësimi i këtij sistemi dhe mungesa e përcaktimit të nevojave për përmirësim, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 të Ministrisë të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar me të gjithë elementët e tij përbërës, e reflektuar kjo në mos hartimin e listave me proceset kryesore të punës, në mospërshkrimin e tyre,

si dhe në mungesën e përgatitjes së gjurmës së auditit për operacionet më të rëndësishme që kryen në institucion. Regjistri i riskut së institucionit dhe mbledhjet e grupit të punës për marrjen në analizë të risqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit janë formale. Kjo ka sjellë mungesë marrje përgjegjësie dhe si rrjedhim mungesë monitorimi për minimizimin e tyre. Gjithashtu kanë munguar rregulla të qarta për mënyrën e ruajtjes e qarkullimit të dokumentacionit që përdoret nga recepsionet dhe për administrimin e vlerave financiare prej tyre.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Vlorë, të hartohet dhe miratohet rregullorja e re e institucionit në të cilën të përshkruhen me hollësi detyrat dhe përgjegjësitë për secilin punonjës.

Nga Titullari i institucionit dhe auditit i brendshëm të analizohet sistemi i kontrollit të brendshëm dhe të përcaktohen ato procedura dhe veprimtari që kanë nevojë për përmirësim, duke hartuar rregulla dhe procedura të reja për to.

Për operacionet më të rëndësishme që kryen në institucion, të hartohet lista me proceset kryesore të punës dhe të përshkruhet me hollësi kryerja e procesit, si dhe të përgatitet gjurma e auditimit.

Të hartohet regjistri i riskut nga secili nivel kryesor menaxherial, ku të përcaktohet efekti negativ, shkalla e mundësisë së ndodhjes së ngjarjes, si dhe personat përgjegjës për adresimin e riskut.

Të përcaktohen rregulla të brendshme konkrete për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të institucionit.

Të plotësohet çdo fillim viti nga Titullari raporti vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e procedurave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të vlerësimit të ofertave për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 9-mujori i vitit 2015, pothuajse në të gjitha tenderat me objekte të ndryshme, nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe nga anëtarët e KVO u konstatuan këto mangësi:

- Procesverbalet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave janë firmosur si të pranishëm edhe nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, veprim ky në kundërshtim me shkronjën “i”, të pikës 4, të kreut V, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e kriterit për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës.

- Në njësinë e prokurimit është emëruar një punonjës me arsim të mesëm, veprim ky në kundërshtim me pikën 1, kreu V, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

- Dokumentacioni mbi DST bashkëlidhur ftesës për negociim nuk është nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

-Hartuesit e fondit limit, janë ngarkuar edhe me detyrën e anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, kreu V, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në hartimin e raportit përfundimtar nuk i është dërguar për miratim titullarit të autoritetit kontraktor dhe është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO, veprim ky në kundërshtim me

VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citon “... KVO pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përfundimtarë dhe ia dërgon për miratim titullarit të AK...”

- Oferta ekonomike nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të KVO-së, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4(hapja dhe vlerësimi i ofertave) germa (b).

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Titullari i Autoritetit Kontraktor që në vazhdimësi të bëhet ndarja e detyrave të nëpunësve që merren me procedurat e prokurimeve publike dhe ngritjen e grupeve të punës për përcaktimin e fondit limit para nxjerrjes së urdhrin të prokurimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderat e zhvilluar me objekt “ *Ruajtja e objekteve të SR Vlorë me punonjës shërbimi në 5 raste* ”për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, nga ana e SR Vlorë, nuk është realizuar mbikëqyrja e kontratave dhe nuk janë hartuar raporte përmbledhës në përfundim të kontratave dhe njohja e subjekteve me këto raporte përmbledhëse sipas kontratave dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia.... e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,...Autoriteti kontraktor, ...mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Drejtoria që në vazhdimësi të ngrihen grupe pune të posaçme për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave dhe të mbahen raporte përmbledhëse dhe t’i bëhen të njohur subjekteve kontraktuese.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste mbi zbatim e kontratave dhe lëvrimin e mallrave me vlerë 20,709,997 lekë është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim, por nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratave dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,...Autoriteti kontraktor, ...mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa, nga Drejtoria e spitalit që në zbatim të kontratave për mallra, të ngrihet komisioni me specialistë të fushës dhe të mbahen procesverbale për marrjen në dorëzim të mallrave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratave të lidhura për vitin 2015, u konstatua se në zbatimin e punimeve civile të tenderit me objekt “Rikonstruksion i disa nyjeve sanitare të Spitalit Rajonal Vlorë” nga Autoriteti Kontraktor nuk janë bërë monitorime sipas e kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,... Autoriteti kontraktor, ... mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për monitorimin e jashtëm (që kryhet përmes vizitave, ose intervistimit) përgjatë, ose pas përfundimit të kontratës. Drejtorja e spitalit të jetë e përgatitur për monitorimin e jashtëm/vizitat në terren dhe duhet të ofrojë të gjithë informacionin/dokumentacionin e nevojshëm. Gjatë kryerjes së monitorimit të jashtëm AK mund të ndihmohet nga Mbikëqyrësi i Zbatimit të Punimeve. Sidoqoftë, në çdo rast, mbikëqyrësi do të përfshihet në monitorimin e kontratave gjatë zbatimit të tyre.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave në prokurimet publike sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike” për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 9-mujori i vitit 2015 nga titullarët e Spitalit Rajonal Vlorë u konstatua:

- Mungon urdhëri i Titullarit për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga 3 specialistë të fushës, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “ç”, VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në disa raste anëtarët e KVO (Kryetari, ose anëtarë), janë ngarkuar edhe si hartues të fondit limit veprim ky në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, kreu V, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në njësinë e prokurimit është emëruar një punonjës me arsim të mesëm, veprim ky në kundërshtim me pikën 1, kreu V, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

- Mungon urdhëri i Titullarëve për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga 3 specialistë të fushës, për çdo tender një javë para zhvillimit të tenderit. veprim ky në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “ç”, VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga Titullari i SR Vlorë, të merren masa për të eliminuar pjesëmarrjen e anëtarëve të KVO-së në grupet e punës për përcaktimin e fondit limit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave të përfshihen specialistë të fushave përkatëse e veçanërisht në tenderat për blerjen e medikamenteve.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë 32 “Objekte Inventari ”janë përfshirë dhe aktive të qëndrueshme të trupëzuara që janë me vlerë mbi 10 mijë lekë dhe në pozicionet financiare të pasyruara në bilancet e viteve dhe këto llogari nuk kundrojnë, rezulton të jenë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit. Gjithsesi prej evidencave të

pasqyruara rezulton, se në këtë inventar bëjnë pjesë edhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë pra në këtë inventar rezulton se shuma prej 5,505,428 lekë që duhet të inventarizohej dhe kontabilizohej në llogarinë 218. Veprim i cili është në kundërshtim me nenin 29 Udhëzim Nr. 30, Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes së tyre”, i cili shprehimisht sqaron se “...Kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit...”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Bazuar në standardet e kontabilitetit publik, nga sektori i financës të bëhen sistemimet në kontabilitet për shumën 5,505,428 lekë, nga llogaria e aktiveve afatshkurtra në llogarinë e aktiveve afatgjata.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: U konstatua se nëpunësit që largohen nga puna nuk dorëzojnë inventaret në ngarkim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” pika 13.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, të marrë masa që të mos bëhen likuidimet përfundimtare për punonjësit që ndërpresin marrëdhëniet e punës pa dorëzuar detyrën dhe inventarët në ngarkim.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatua se, janë copëzuar fondet në 3 raste në vlerën totale 2,137,230 lekë, konkretisht për vitin 2012-2013 janë kryer shpenzime për materiale kancelarike në 2 raste në vlerën 1,581,690 lekë, ndërsa për vitin 2014 në një rast në vlerën 555,540 lekë, duke tejkaluar limitin e lejuar prej 400,000 lekë. Veprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, kreu i VI pika 2/a, si dhe udhëzimin Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar pika 1, pika 3 dhe pika 4.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë të marrë masa për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit (duke vendosur strukturat zbatuese të miratuara nga titullari) si dhe të mos tejkalojë limitin e lejuar për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënien e objekteve me qira u konstatua se katër qiramarrës nuk kanë kryer rregullisht pagesat e qirasë mujore dhe janë debitorë ndaj spitalit në vlerën 657,475 lekë, vlerë e konstatuar nga grupi i auditimit pasi zyra e financës nuk ka evidentuar emrat e debitorëve dhe as vlerën e debisë. Vlerësimi u bazua në kontratat e lidhura, detyrimet që lindin prej tyre dhe krahasimet e këtyre detyrimeve me pagesat e kryera (në arkë dhe bankë).

Në zyrën e financës nuk ka regjistër të veçantë të aktiveve për pronat e dhëna me qira, ku të evidentohet sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, veprimtaria që kryhet, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve etj. Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me pikën (g) neni 12 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe në kundërshtim me paragrafit 31 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ngarkojnë me përgjegjësi përgjegjësat e financës

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga nëpunësi zbatues të hartohet regjistri i veçantë i aktiveve për pronat e dhëna me qira për periudhën 2013-2015, si dhe të vazhdohet plotësimi i tij në vazhdimësi. Të pasqyrohen në dokumentat financiar të institucionit emrat e debitorëve dhe detyrimi i tyre. Nga Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës 657,475 lekë nga debitorët për pronat e dhëna me qira, spas listës së lënë nga KLSH.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënien e objekteve me qira u konstatua se në tre raste të lidhjes së kontratave të cilat tashmë janë të zgjidhura për arsye të mbarimit të afatit, dhe konkretisht në lidhjen e kontratës me për periudhën 22.10.2012 -17. 04. 2013 (sipërfaqja 1,000 m²), me për periudhën 17.04.2013 deri 21. 02. 2014 (sipërfaqja 1,000 m²) dhe me për periudhën 01.08.2014 -01. 08.2015, (sipërfaqja 500 m²), janë tejkaluar kompetencat nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, duke vepruar në emër të institucionit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore. Drejtoria e Spitalit nuk ka pasur të drejtën e lidhjes së këtyre kontratave për arsye se: a) sipërfaqja e dhënë me qira është mbi 200 m² dhe b) spitali nuk ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore. Me veprimet e mësipërme është vepruar në kundërshtim me pikën nr. 6, kreu I, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ku thuhet se: “Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e ka organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror, i cili jep me qira, deri në 20 (njëzet) vjet, sipërfaqe mbi 200 (dyqind) m².”

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të ndalohet rreptësisht lidhja e kontratave nga ana e Spitalit Rajonal Vlorë për sipërfaqe për të cilat institucioni nuk ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore dhe që janë mbi 200 m². Për këto raste të përgatitet dokumentacioni i nevojshëm dhe të përcillet në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili ka të drejtën të fillojë procedurat për dhënien me qira të pasurisë shtetërore.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënien e objekteve me qira u konstatua se në 12 raste të lidhjes së kontratave (gjashtë në vitin 2012, katër në vitin 2013 dhe dy në vitin 2014), nuk i është kërkuar qiramarrësit të kryej pagesën e garancisë së kontratës, përpara nënshkrimit të saj, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të pagesës së qirasë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me paragrafin 14, kreu II të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe ngarkojnë më përgjegjësi me detyrë ish- juriste të institucionit.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga Titullari i institucionit dhe zyra juridike, të merren masa që në rastin e lidhjes së kontratave për dhënien e objekteve me qira, të kërkohet nga qiramarrësi kryerja e pagesës së garancisë së kontratës përpara nënshkrimit të saj.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë e përdorimit të mandat-arkëtimeve dhe derdhjen e vlerave financiare në arkë, u konstatua se për të gjithë periudhën e audituar nuk është bërë asnjë akt-rakordim midis përgjegjësave të financës arkëtares qendër dhe recepsioneve, lidhur me sasinë e blloqeve të mandat-arkëtimeve të marrë dhe të kthyer, si dhe nuk është verifikuar rregullshmëria e përdorimit të tyre. Tërheqja e blloqeve nga magazina për periudhën janar 2012 prill 2015 nuk është bërë nga resepsionisti, por nga arkëtarja e spitalit, pa urdhërdorëzimi, pa fletëkërkesë nga përdoruesi, pa plan shpërndarje, si dhe pa u shënuar numrat serial të tyre. Numrat rendor nuk kanë vazhdimësi nga një bllok mandat-arkëtimi te tjetri. Të gjitha këto kanë krijuar hapsira për mosdorëzim të vlerave financiare dhe së bashku me to edhe të mandat-arkëtimeve. Kështu në 65 raste recepsionistia [REDACTED] në kundërshtim me detyrën e saj funksionale, nuk ka dorëzuar në arkën qendrore të institucionit as vlerat financiare dhe as mandat-arkëtimin. Vlera totale e përfituar prej saj është 295,000 lekë dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e Spitalit Rajonal Vlorë. Vlera e mësipërme është llogaritur mbi bazën e njerës kopje të mandat-arkëtimit të padorëzuar, i cili i është dhënë pacientes nga recepsionistia dhe është vendosur nga mjeku në kartelën e pacientes në pavion.

Fenomeni i mosdorëzimit të blloqeve nga recepsionistia [REDACTED] është konstatuar nga ish-specialistia e auditit të brendshëm [REDACTED], por nuk është zgjeruar auditimi në zbulimin e vlerave financiare të padorëzuara, duke mos dhënë një siguri objektive për drejtimin e institucionit dhe duke mos kryer auditim profesional, nëpërmjet metodave krahasuese të të dhënave që japin regjistrat e recepsionit, të pavionit, si dhe kartelat e pacientëve.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Auditi i brendshëm të analizojë dhe të vlerësojë konstatimet e nxjerra nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit të pasqyruara në raportin përfundimtarë, lidhur me veprimtarinë e punonjësës [REDACTED] dhe rasteve të ngjashme.

Deri me datë 31.03.2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Spitali Rajonal Vlorë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **3,853,770 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dhënien e objekteve me qira në dy raste u konstatua se është lidhur kontratë në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, duke shkaktuar në total një dëm ekonomik në vlerën 1,112,000 lekë për buxhetin e Spitalit Rajonal Vlorë. Konkretisht në kontratën e lidhur me [REDACTED] në datën 22.10.2012 dhe me [REDACTED] në datën 17.04.2013, për dhënien me qira të sipërfaqes truall 1,000 m² për parkim, tarifa e qirasë mujore është vendosur 30 lekë/m², vlerë kjo më e ulët se tarifa dysHEME 100 lekë/m² që përcakton VKM e mësipërme. Si rezultat:

- nga qiramarrësi janë përfituar padrejtësisht 408,333 lekë,
- nga qiramarrësi janë përfituar padrejtësisht 703,667 lekë.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore, që të kërkohet shlyerja e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ulja e tarifës së qirasë mujore, në vlerën 408,333 lekë nga dhe në vlerën 703,667 lekë nga Gjatë lidhjes së kontratave për dhënien e objekteve me qira, të zbatohen tarifat e qirasë mujore që përcakton legjislacioni në fuqi.

Deri me datë 31.01.2016

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në urdhër shpenzimet për vitet 2012, 2013, 2014 rezultoi se Spitali Rajonal Vlorë për zërin shpenzime telefonike ka paguar tepër kamatvonesa në vlerën 118,255 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi Spitali Rajonal është i detyruar të paguaj faturën mujore brënda harkut kohor të përcaktuar nga nga të cilët:

- 56,964 lekë për për zërin shpenzime telefonike të paguara më tepër për periudhën 01.02.2012 deri 22.04.2013.
- 61,291 lekë për për zërin shpenzime telefonike të paguara më tepër për periudhën 16.04.2013 deri 19.02.2014.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Nga titullari i Institucionit të kërkohet duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 56,964 lekë nga dhe 61,291 lekë nga Në të ardhmen Drejtoria e spitalit Vlorë të marrë masat që faturat për shpenzimet telefonike të paguhen brenda harkut kohor të përcaktuar nga

Deri me datë 28.02.2016

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve civile u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Spitalit Vlorë në vlerën 321,833 lekë dhe konkretisht:

- 218,945 lekë nga shoqëria në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i disa nyjeve sanitare të Spitalit Rajonal Vlorë”.
- 102,888 lekë nga shoqëria në tenderin me objekt “Ndërtimi i sistemit të ngrohjes, të ftohjes dhe rrjetit elektrik për spitalin e pediatriisë”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Titullari i spitalit Vlorë, që ti kërkohet operatorit ekonomik duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 321,833 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Deri me datë 28.02.2016

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave në tenderat e zhvilluar për vitet 2012 dhe 2013 u konstatua se nga dy operator ekonomik, në tenderit me objekt “Blerje medikamente, 2012” dhe “Blerje ushqimore për Spitalin Rajonal Vlorë, 2013” pas shpalljes si fitues janë tërhequr jashtë afatit në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, kreu III, germa (e) dhe në këto kushte nga Autoriteti Kontraktor duhej të konfiskohej sigurimi i ofertës në vlerën

110,680 lekë, që përbën dëm ekonomik nga të cilët:

-76,346 lekë ndaj operatorit ekonomik [REDACTED] për tenderin me objekt “Blerje medikamente, 2012”.

- 34,334 lekë ndaj operatorit ekonomik [REDACTED] për tenderin “Blerje ushqimore për Spitalin Rajonal Vlorë, 2013”.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Drejtoria e Spitalit Vlorë të marrë masat që t’i mbajë operatorit ekonomik [REDACTED] shumën 76,346 lekë dhe operatorit ekonomik [REDACTED] shumën 34,334 lekë, si konfiskim i sigurimit të kontratës.

Deri me datë 28.02.2016

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bërë për zbatimin e procedurave në tenderat për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 9-mujori i vitit 2015, në 8 raste, u konstatua se Njësia e Prokurimit ka rritur fiktivisht fondin limit në vlerën 1,698,358 lekë, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Spitalit Rajonal Vlorë, veprim ky në kundërshtim me germen “c” dhe “ç” të pikës 2 të kreut II të VKM nr. 1, date 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, nga të cilat:

- 398,358 lekë në tenderin “Blerje kite ragente, 2012” dhe ngarkon me përgjegjësi ish Kryetarin e Shefit Planit, [REDACTED].

- 684,528 lekë në tenderin “Ndërtimi i sistemit të ngrohjes dhe rrjetit elektrik për spitalin e pediatriisë, viti 2015” dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesin e projektit dhe preventivit [REDACTED].

- 53,064 lekë në tenderin “Blerje uniforma, veshmbathje për personelin për nevoja të SRV, 2012” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

- 49,988 lekë në tenderin “Shërbim me roje private për nevojat e spitalit rajonal Vlorë, 2012” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

- 282,120 lekë në tenderin “Shërbim me roje private për nevojat e spitalit rajonal Vlorë, 2013” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

- 58,000 lekë në tenderin me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje për personelin për nevoja të spitalit rajona Vlorë, viti 2014” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

- 96,000 lekë në tenderin me objekt “Mirëmbajtje e automjeteve për Spitalin Rajonal Vlorë, viti 2014, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

- 76,300 lekë në tenderin me objekt “Mirëmbajtje e automjeteve për Spitalin Rajonal Vlorë, viti 2015, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit, [REDACTED].

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Titullari i spitalit Vlorë, që ti kërkojë personave përgjegjës shpërblimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës për:

- 398,358 lekë nga [REDACTED]

- 684,528 lekë nga hartuesi i preventivit [REDACTED]

- 53,064 lekë nga [REDACTED].

- 49,988 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, [REDACTED]

- 282,120 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit [REDACTED]

- 58,000 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, [REDACTED]

- 96,000 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, [REDACTED]

- 76,300 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, [REDACTED]

Deri me datë 28.02.2016

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e procedurave për levrimin e mallrave dhe marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 9-mujori i vitit 2015, në 5 raste, u konstatua se nga Operatorët ekonomikë është lëvruar karburant me çmim më të lartë se çmimi i ofertës, duke rritur padrejtësisht marzhin e fitimit dhe duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Spitalit Rajonal Vlorë në vlerë 197,644 lekë, veprim ky në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, Pika 2/c ku thotë “ ... Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës...ndryshon dukshëm..., me kërkesë me shkrim të palëve...pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SA ...”, nga të cilët:

- 36,760 lekë në tenderin “Blerje karburanti, viti 2014, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik [REDACTED] sepse ka lëvruar karburant me 3.51 lekë për litër më tepër se çmimi i ofertës.

- 14,260 lekë në tenderin “Blerje karburanti, viti 2014, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik [REDACTED] sepse ka lëvruar karburant me 2.43 lekë për litër më tepër se çmimi i ofertës.

- 63,080 lekë në tenderin “Blerje karburanti, viti 2014, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik [REDACTED] sepse ka lëvruar karburant me 11,796 lekë për litër më tepër se çmimi i ofertës.

- 50,760 lekë në tenderin “Blerje karburanti, viti 2015, për Spitalin Rajonal Vlorë” dhe ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik [REDACTED], sepse ka lëvruar karburant me 2,4 lekë për litër më tepër se çmimi i ofertës.

- 32,784 lekë në tenderin “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë, viti 2014” dhe ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik [REDACTED] sepse ka lëvruar karburant me 2,19 lekë për litër më tepër se çmimi i ofertës.

Sa më sipër, është rekomanduar:

Të merren masa nga Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, që t’i kërkojë operatorëve ekonomik shpërblimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës për:

- 36,760 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga levrimi i karburantit me çmim të rritur.

- 14,260 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED], për dëmin ekonomik të shkaktuar nga levrimi i karburantit me çmim të rritur.

- 63,080 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED], për dëmin ekonomik të shkaktuar nga levrimi i karburantit me çmim të rritur.

- 50,760 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED], për dëmin ekonomik të shkaktuar nga levrimi i karburantit me çmim të rritur.

- 32,784 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED], për dëmin ekonomik të shkaktuar nga levrimi i lëndes djegëse, me çmim të rritur.

Deri me datë 20.03.2016

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe kontratës individuale neni 9, kërkojmë nga Drejtori i Spitalit Rajonal, Vlorë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. I lihet në kompetencë Drejtorisë dhe Këshillit Tekniko-Administrativ të marrë masat disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit **për 13 punonjës** si më poshtë:

1. [REDAKTUAR], me detyrë Nëndrejtor i Spitalit në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit për:

-Mosargumentim të fondit limit në tenderin “Blerje kite reagente”. Nuk ka përcaktuar specifikimet teknike në tenderin “Blerje pajisje mjeksore” në kundërshtim me nenin 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Për mosargumentim të saktë të fondit limit në tenderin “Blerje oksigjen i gazët mjeksorë”. Mosargumentim në zgjedhjen e procedurës së prokurimit në tenderin “Blerje oksigjen i gazët mjeksorë”.

2. [REDAKTUAR], me detyrë Përgjegjëse Hotelerie në cilësinë e anëtarit të KVO,

3. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO për:

-Hartim procesverbalesh në kundërshtim me LPP në tenderin “Blerje dyshekë” në tenderin “Blerje pajisje mjeksore”, dhe në tenderin “Blerje materiale mjekimi”. Për s’kualifikim të padrejtë të OE [REDAKTUAR] me dëm ekonomik prej 398,358 lekë. Për mosargumentim të fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 53,064 lekë dhe nënshkrimin të formularit të deklarimit se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit duke qenë anëtare e KVO. Për mosargumentim dhe rritje të fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 58,000 lekë në tenderin “Blerje uniforma, veshmbathje për personelin”. Hartues i fondit limit është njëkohësisht edhe kryetar i KVO-së, në tenderin “Blerje kite reagente” si dhe në tenderin “Blerje materiale mjekimi”. Për kualifikim të padrejtë në tenderin “Blerje kite reagente”. Oferta ekonomike nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të KVO-së, në tenderin “Blerje karburant për emergjencë” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4 (hapja dhe vlerësimi i ofertave) germa (b), ç’ka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së”.

4. [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryetarit të KVO-së,

5. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

6. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

7. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

8. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për:

-Pasi oferta ekonomike nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të KVO-së, për tenderin “Blerje karburanti” si dhe tenderin “Blerje karburanti, 2014” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4, germa (b). Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit të AK dhe është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO, për tenderin “Blerje karburanti” si dhe tenderin “Blerje karburanti, 2014” veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

9. [REDACTED], me detyrë përgjegjës i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe llogaritjes së fondit limit:

-Për mosargumentim të fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 96,000 lekë në tenderin “Mirëmbajtje e automjeteve për spitalin Vlorë, viti 2014”, dhe 76,300 lekë në tenderin “Mirëmbajtje e automjeteve për spitalin Vlorë, viti 2015”. Mosargumentim në zgjedhjen e procedurës së prokurimit në tenderin “Blerje oksigjen i gazët mjeksorë”. Nuk ka përcaktuar specifikimet teknike në tenderin “Blerje pajisje mjeksore” në kundërshtim me nenin 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Për mosargumentim të fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 49,988 lekë në tenderin “Shërbim me roje private, 2013” dhe 282,120 lekë në tenderin “Shërbim me roje private, viti 2013”. Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit të AK dhe është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO, për tenderin “Evadim mbeturinash” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

10. [REDACTED], me detyrë arkëtare e institucionit:

-Për shpërndarjen e mandatë-arkëtimeve pa dokumentacionin e duhur, moskryerja e rakordimeve me recepsionistët për dorëzimin e tyre, mosinformim të eprorëve për mosdorëzim të mandatë-arkëtimeve nga recepsionistët, veprime këto që kanë sjellë pasoja të mosdorëzimit të të gjitha vlerave financiare prej tyre.

11. [REDACTED], me detyrë recepsioniste e institucionit,

-Për mosdorëzim në arkën e institucionit të vlerës prej 295,000 lekë, për mosdorëzim të të gjithë mandatë-arkëtimeve të tërhequra, si dhe për dorëzime të vonuara të vlerave financiare në arkën e institucionit.

12. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për:

- Nuk ka përcaktuar specifikimet teknike në tenderin “Blerje pajisje mjeksore” në kundërshtim me nenin 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

13. [REDACTED], në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit,

- Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit të AK dhe është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO, për tenderin “Blerje material mjekimi” dhe për tenderin “Evadim mbeturinash” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

II. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese, ligjzbatuese, të cilët mund të vlerësohen me masën disiplinore “**Vërejtje me shkrim**”, në varësi të përgjegjësisë së konstatuar për **8 punonjës** si më poshtë:

1. [REDACTED], në cilësinë e Kryetarit të KVO:

-Për hartim procesverbalesh në kundërshtim me LPP në tenderin “Blerje dyshekë”, në tenderin “Blerje pajisje mjeksore”, në tenderin “Blerje materiale mjekimi”. Për s’kualifikim të padrejtë të OE [REDACTED] me pasojë dëmin ekonomik prej 398,358 lekë. Për mosargumentim të fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 53,064 lekë dhe nënshkrimin të formularit të deklarimit se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit duke qenë anëtar i KVO-së. Për mosargumentim dhe rritje te fondit limit me pasojë dëmin ekonomik prej 58,000 lekë në tenderin “Blerje uniforma,

veshmbathje për personelin”. Hartues i fondit limit është njëkohësisht edhe kryetar i KVO-së, në tenderin “Blerje kite ragente” dhe “Blerje materiale mjekimi”. Për kualifikim të padrejtë në tenderin “Blerje kite ragente”. Oferta ekonomike nuk është firmosur në tenderin “Blerje karburant për emergjencë” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4.

2. [REDAKTUAR] me detyrë ish juriste e institucionit dhe në cilësinë e hartuesit të kontratës, për:

- Në dy raste ka përcaktuar në kontratë çmimin për m² më të ulët se çmimi dysHEME që përcakton VKM nr. 529, datë 08.06.2011, me pasojë shkaktimin e një dëmi ekonomikë prej 1,112,000 lekë. Përpara nënshkrimit të kontratës së qirasë nuk i është kërkuar qiramarrësit të kryej pagesën e garancisë së kontratës. Tejkalim kompetencash në hartimin e dy kontratave, duke hartuar kontrata që janë kompetencë e organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore. Lidhje kontrate në tenderin “Blerje medikamente për SRV” dhe tenderin “Blerje karburant për emergjencë, 2013” pa u bërë nga OE sigurimi i kontratës 10% të vlerës së saj. Nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallrave sipas kontratës dhe kërkesave të VKM nr.1, datë 10.01.2007. Mosargumentim në zgjedhjen e procedurës së prokurimit në tenderin “Blerje oksigjen i gazet mjeksorë”. Nuk ka përcaktuar specifikimet teknike në tenderin “Blerje pajisje mjeksore” në kundërshtim me nenin 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

3. [REDAKTUAR] me detyrë ish juriste e institucionit dhe në cilësinë për:

- Hartuese e kontratës, në një rast për tejkalim të kompetencave në hartimin e kontratave, duke hartuar kontrata që janë kompetencë e organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore. Përpara nënshkrimit të kontratës së qirasë nuk i është kërkuar qiramarrësit të kryej pagesën e garancisë së kontratës. Lidhje kontrate në tenderin “Furnizim me lëndë djegëse për automjete diesel për nevoja të spitalit” pa u bërë nga OE sigurimi i kontratës 10% të vlerës së saj. Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit të AK për tenderin “Blerje material mjekimi” dhe për tenderin “Evadim mbeturinash” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

4. [REDAKTUAR] me detyrë ish përgjigjës i financës, për:

- Moskryerjen e rakordimeve dhe kontrolleve për rregullshmërinë e përdorimit të mandatë-arkëtimeve nga receptionistët, me pasojë mosdorëzimin e të gjitha vlerave financiare prej tyre, mosevidentimi dhe mosparaqitja në dokumentat financiar të debitorëve nga kontratat për dhënie me qira për vitin 2012 në vlerën 117,350 lekë, për vitin 2014 në vlerën 208,000 lekë, për mosmbajtje të rregjistrimit të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira.

- Mosargumentim në zgjedhjen e procedurës së prokurimit në tenderin “Blerje oksigjen i gazet mjeksorë”. Nuk ka përcaktuar specifikimet teknike në tenderin “Blerje pajisje mjeksore” në kundërshtim me nenin 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 4, datë 26.11.2015). Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit për tenderin “Evadim mbeturinash” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

5. [REDAKTUAR] me detyrë ish përgjegjës i financës.

6. [REDAKTUAR] me detyrë ish përgjegjës i financës.

Për moskryerje e rakordimeve dhe kontrolleve për rregullshmërinë e përdorimit të mandatë-

arkëtimeve nga recepsionistët, mosevidentimi dhe mosparaqitja në dokumentat financiar të debitorëve nga kontratat për dhënien me qira, për vitin për vitin 2013 në vlerën 285,300 leke, dhe për vitin 2015 në vlerën 118,400 lekë për mosmbajtje të rregjistrit të veçantë për secilën nga objektet e dhëna me qira.

7. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit,

8. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit për:

Raporti përfundimtarë nuk i është dërguar për miratim Titullarit të AK për tenderit “Blerje material mjekimi” dhe “Evadim mbeturinash” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin Nr. 12, datë 17.02.2016 ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja si dhe Shoqërive Publike.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 20.10.2015 deri 20.12.2015, nga grupi i auditimit Skënder Muça Përgjegjës grupi, Pal Daçi, Berti Meçaj, Jonild Hoxhaj, Rezart Golemi dhe Ramadan Zejnuni anëtarë, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj dhe Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve z. Ermal Yzeiraj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT